



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 060 - 24486/23
Klinë, datë: 26.07.2023

PROCESVERBAL

Nga Debatit me Publikun në fshatin Drenoc, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "ISA BOLETINI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Ulët dhe Dugajevë. Tubimi u mbajt me datë 16 qershor 2023 dhe filloi në orën 19:00, ku morën pjesë: 31 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave ka bërë një prezantim në pika të shkurtra projektet e planifikuara infrastrukturore në këto zona e lartcekura.

Kryetari Elezaj me një fjalë rasti gjatë hapjes së këtij takim falënderoi banorët për pritjen e madhe që çdo herë po i bëhet në këto lokalitete si dhe kontributin e dhënë dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këto dëgjim. Ai informoi të pranishmit mbi investimet që pritet të ndodhin në këto lokalitete që janë në fazën e prokurimit publik 110 mijë euro investime të reja të cilat do të implementohen në projekte brenda këtij viti. Gjithashtu theksoi se gjatë takimeve të shumta edhe brenda komunës me banorë të ndryshëm të Pjetërqit, Drenocit e Dugajevës është në dijeni për problemet me të cilat ballafaqohen.

Pas kryetarit të komunës, fjalë ju dha të pranishmëve, banorëve nga Drenoci, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Ulët dhe Dugajeva.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Idriz Rama - Drenoc, lagja “Shaip Regjepi”, kishte pyetje rreth investimeve në lumin që kalon në fshatin Drenoc dhe shqetësim i tij mbetën vërshimet dhe si janë mundësit institucionale për të siguruar fondet për këtë projektin e ndërtimi të shtratit të këtij lumi ?

Halil Avdiu - Drenoc, përfaqësues i fshatit, kërkon ujë të pijes, ndriçim dhe 1.5 km kanalizim, po ashtu 1.5 km asfaltim. Thekson se varrezat dhe lumi janë një ndër sfidat e lokalitetit Drenoc, ku së fundmi lumi ka dalë nga shtrati duke bërë dëme nëpër fushat e tyre.

Kryetari Elezaj i përgjigjet: Uji i pijes është një sfidë, sepse së bashku me “Hidrodrinin” jemi duke tentuar të zgjasim një tubacion të ujit nga fshati Pjetërq deri në Drenoc, por ende mbetet të shihet. Alternativë tjeter që kemi menduar ishte nëpërmes Gllogjanit me UNDP, por ende pa rezultat. Mbetet të punohet rreth kësaj kërkese. Ndërkaq, rreth shtratit të lumit do të punohet me gurët e minuar për të rregulluar shtratin e lumit.



Ismet Jagoda – Përfaqësues i fshatit Pjetërq i Epërm, në emër të banorëve të fshatit para të prnishmëve parashtroi këto kërkesa: 1. Asfaltimin e rrugës nga shkolla e fshatit, deri te rruga “Ramë Jagoda”, me gjatësi afér 300 metra, 2. Trotuar nga rruga magjistrale e deri në qendër të fshatit për fëmijët që shkojnë në shkollë, 3. Ndriçimi është i dëmtuar në disa lagje, kërkon të rregullohet, 4. Asfaltimi i rrugës tek banori Smajl Haxhia.

Përfaqesuesit të fshtit **Pjetërq i Epërm**, ju përgjigj **Drejtori i Inspektoratit, z. Faruk Smajli**, ai tha se rreth rrugës, se do të shtrohen me zhavorr, pasi që ka qenë dhe ka matur rrugën dhe është në këtë projekt. Po ashtu ndriçimi është vlerësuar nga një komision dhe shumë shpejtë priten të ndërrohen dritat e dëmtuara.

Skender Daka - Fshati Pjetërq i Ulët, kërkon asfaltimin e rrugës për te varrezat, dy rrugë fushore në total 1100 metra si dhe ndriçimi të bëhet në disa lagje të fshatit Pjetërq i Ulët.

Mark Marku - Fshati Drenoc, kërkesë të përfshihen në kanalizim disa shtëpi në lagjen “Marku.”

Kryetari Elezaj i përgjigjet se kanalizimi do të kryhet sivjet. Ndërkaq kërkesat tjera do të planifikohen në projekte të ardhshme.



Faton Gojani - Fshati Dugajevë, kërkon asfaltimin e një rruge 1000m me drejtim nga Pjetërqi, nga lagja e “Bytyqve”.

Avni Avdyli - Fshati Drenoc, Ankohet për gjendjen e lumit që po i shkaktohen dëme nga vërshimet, dhe ka mbjellë vetëm 2 hektarë sepse ka dëme të mëdha nga vërshimet. Po ashtu, ka ngelur pa marrë subvencione nga dëmet dhe nga mungesa e mjeteve për të marrë tokat e reja me qira. Ndërsa si kërkesë paraqiti shtrimin e rrugëve fushore në Drenoc.

Dedë Berisha – Dugajevë, kërkon që të shikohet gjendja e Bistricës, sepse ka gërryer shumicën e pronës bujqësore, dhe s’ka mbetur vetëm 2 metra që të kalojë në atë rrugë. Ruga quhet “Pren Gojani”.

Shaqir Fejza – Fshati Drenoc, Kërkon shtrirjen e rrjetit te ndriçimit në Drenoc.

Luz Gojani – Dugajevë, thotë se ekzistojnë disa probleme me kanalizimet, sepse pusetat janë të thyera, dhe po ashtu nuk janë të vendosura mirë. Disa janë më të thella dhe disa janë mbi tokë dhe pengojnë rrugëtimin. Kërkon që të ketë kontrolla më të shpeshta të ingjinierëve apo menaxherëve të kontratave në inspektim të projekteve në teren.

Vilson Gjonaj: Ankohet se kanalizimi është punuar shumë dobët, dhe nuk ka rrjedhje të mirë edhe ai kërkon që të ketë kontrolla më të shpeshta të ingjinierëve apo menaxherëve të kontratave në inspektim të projekteve në teren.

Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt Drenoc, në objektin e shkollës

fillore të mesme të ulët "ISA BOLETINI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Ulët dhe Dugajevë, morën pjesë: 31 persona.


Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	1
Meshkuj	30
Total:	31

Takimi përfundoi në orën 20:24.

Procesmbajtësi:

Nikson Daka



Klinë, datë:

